

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
 AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2008

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E hënë, 9 qershor 2008

Ora 10.00

Lënda: Letërsi

Shkolla e mesme teknike profesionale (3+2) dhe 5 vjeçare

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në prozë dhe në poezi.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rretho **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

|         |     |     |     |     |     |     |     |     |     |    |     |     |     |
|---------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|----|-----|-----|-----|
| Kërkesa | 1   | 2   | 3   | 4   | 5   | 6   | 7   | 8   | 9a  | 9b | 10a | 10b | 11a |
| Pikët   |     |     |     |     |     |     |     |     |     |    |     |     |     |
| Kërkesa | 11b | 11c | 12  | 13a | 13b | 13c | 13d | 14  | 15  | 16 | 17  | 18  | 19  |
| Pikët   |     |     |     |     |     |     |     |     |     |    |     |     |     |
| Kërkesa | 20a | 20b | 20c | 21a | 21b | 21c | 21d | 22a | 22b | 23 | 24a | 24b | 25  |
| Pikët   |     |     |     |     |     |     |     |     |     |    |     |     |     |

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****Mitrush Kuteli****Rinë Katerinëzë,**  
(Fragment)

Aq fort e deshi Kirollo Katerinëzën, sa desh ta bënte mollë ta mbante në gji.

- Ç' do deshe të bëhesh ti, o im zot?
- Qipariz, o vasha ime.
- Edhe un driz' e bardhë...

Sa të lumtur ishin që të dy! Rrinin mbi gurë të varrit e u dukej sikur bridhnin nëpër qiell, ne zonja Hënë, ne Kashta e zotit Kumtër e më tej, mal mbi mal e fushë mbi fushë.

Vonë fort Kirolloi hapi gojën e foli:

- Si do që ta lidhim besën, moj ftujza ime? A vjen ti në atë jetë, a të vij unë këtunë?
- Rinë- Katerinëza rrinte e mejtuar.

Vështronte hënë në lart, ujërat poshtë, bar e pemë rreth e rrotull...

Kaq bukuri anembanë, o zot i madh! - Si të ndahesh nga kjo botë?

E meqë ish muaji maj e meqë ish shoshur që lart një re udhëtare, s' di se nga vinte një erë e ëmbël unapi-kaq e ëmbël, sa të bënte të mbyllje sytë. Tjetër gjë më të ëmbël as që ka, përveç vdekjes.

- Tink- tink-tink! Një zile përtej, ciu-ciu! Një shpesh nëpër gjumë, fësh-fësh, era nëpër fletë. Edhe Kirolloi si rusp' i bukur, aty pranë.

Foli trimi:

- Atje ku jam unë, muaji maj s'ka të sosur, jargavani s'e shkund lulen, shpesi s'ka të ikur. Atje jo vetëm dheri, po edhe qielli është yni, ngjitemi e zbresim mbi krahë fluturash të bardha, vemë e vijmë e gazi s'ka të sosur, në jetën e jetës!

Foli vasha:

- Nuk e di si është atje, o im zot, se as syri më ka parë, as këmba më ka shkelur. Po se ma thua ti, s'ka se qysh mos të jetë e bukur. Dhe unë...

Në atë çast ku vendosej jeta për këtej a për andej, më ç'u ngrit nga fletët një këngë shpesi kaq e ëmbël, kaq zotëronjëse, sa edhe vetë Kirolloi që kish dëgjuar shpesët-mjeshtër, përtej, mbajti veshin edhe dëgjoji.

Rinë- Katerinëza duke dëgjuar filomelën, hodhi një sy nga varri i hapur, ku duhej të hynte së bashku me Kirollon, për të zbritur tej, shërëmtiu sa kumboi vendi i gjithë edhe iu afrua më fort kurmit të të zot.

Ish e ngrohtë nata e muajit maj, po më i ngrohtë kurmi i Rinë Katerinëzës.

Shkopsiti gjirin që ta rrahë era.

Dhe çudi e zotit ish gjiri i saj.

Erë ftoi e mjaltë blete!

Iu derdhën flokëzat mbi supe. Flokëza të arta mbi supe si bora.

U drodh Kirolloi, i vdekuri nga kaq bukuri. Anoi kryet e puthi flokët, mbeti pastaj i mekur midis dy botësh.

-Përse dridhesh ftujzë e bardhë?

-Nga e ftohta, o im zot.

Po e ftohta që e bënte vashën të dridhej nuk ish tjetër, po e ftoht' e varrit të hapur. E si i pushtoi mesin me krahn' e majtë, e si i anoi kryet në kraharuar, i foli:

- Për këtu ta lidhim besën, o im zot!

Dhe u ngrit edhe lidhën besën, aty ne varri i s'ëmës, ndënë dritën e zonjës Hënë.

E askush s'duhej të dinte besën e martesës së tyre!

Kjo ishte e lidhura që lidhen.

Dora e së vdekurës u këmbu unazat.

Filomela u këndoi mbi krye.

Zonja Hënë u dëshmoi bashkimin.

Dhe kur zonja Hënë u dëshmonte bashkimin për jetën e jetës, Rinë-Katerinëza më t'u gjend e veshur me ncilonë nusërie, me linjë të lindë e me krahët të mëndafshhtë.

Trëndafil të bardhë mban në krye.

Me ar e me argjend ish qëndisur krez' e saj, me ar e me argjend krahët, me ar e me argjend ncilona.

E gjelbër është fleta e dhrizës, i gjelbër është bari i prillit, po më i gjelbër villusi i krezës së Rinë- Katerinëzës

Dhe ish e bukur si më e bukura Fatë.

Dhe mbetën burrë e grua; ajo e gjallë, ai i vdekur...

E më s'kish helm Rinë-Katerinëza!

As fjala e njerks-nepërkë nuk e bënte të lotojë. Se shpirtin e kish plot me gazin e netëve të Kirolloit.

Për pyetjet 1-7 rretho **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Vetë Kuteli, këtë krijim e quante:

1 pikë

- A) tregim.
- B) ngjarje.
- C) rrëfenjë.
- D) përrallë.

2. Midis ngjarjes dhe lexuesit, autori luan rolin e:

1 pikë

- A) rrëfyesit.
- B) konstatuesit.
- C) vlerësuesit.
- D) ndërmjetësit.

3. Informacioni që na jep pyetja retorike “Si të ndahesh nga kjo botë?”, shpreh:

1 pikë

- A) dëshirën e Rinës për të qenë në botën tjetër.
- B) dilemën e saj për të zgjedhur midis dy botëve.
- C) pendesën për fjalën që i kishte dhënë Kirolloit.
- D) aftësinë për të gjykuar bukurinë e natyrës.

4. Çfarë ideje të krijon koha artistike e rrëfimit?

1 pikë

- A) Idenë e së ardhmes.
- B) Idenë e tejkohësisë.
- C) Idenë e së shkuarës.
- D) Idenë e të sotmes.

5. Subjekti i kësaj proze, ka në qendër mjedisin:

1 pikë

- A) e një bote tjetër.
- B) e fshatit shqiptar.
- C) e një vendi të huaj.
- D) e një familjeje shqiptare.

6. Lidhja e veçantë që krijohet midis Rinës e Kirolloit (midis të gjallit dhe të vdekurit), ngjason më shumë me lidhjen midis personazheve: **1 pikë**

- A) Kostandin dhe Doruntinë.
- B) Halil dhe Tanushë.
- C) Helenë dhe Parid.
- D) Romeo dhe Zhuljetë.

7. Dëshmitarët që marrin pjesë në martesën e Rinës me Kirolloin, janë: **1 pikë**

- A) udhëtarët e natës.
- B) të gjallët dhe të vdekurit.
- C) të afërmit e Rinës.
- D) Zonja Hënë dhe mëma.

8. Kuteli na jep informacion për gjendjen shpirtërore të Rinës. Ndër të tjera edhe që ishte e menduar. Shkruaj dy arsye pse Rina rrinte e menduar. **2 pikë**



---



---

9. Kirolloi i drejtohet Rinës me shumë kujdes dhe dashuri. Gjej dy shprehje, të cilat shërbejnë si provë e dashurisë dhe kujdesit të Kirolloit ndaj saj. **2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

10. Shiko me vëmendje fragmentin nga: “*në atë çast ku vendosej jeta*”, deri te “*Zonja Hënë u dëshmoi bashkimin*”. Cili është detaji më i rëndësishëm këtu? Pas kësaj, mendo dhe shkruaj një titull vetëm për këtë pjesë. **2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

11. Kuteli konsiderohet si shkrimtar që u mbështet dhe e shfrytëzoi mjaft folklorin. Gjej tri elemente folklorikë që autori ka përdorur në këtë fragment. **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

12. Muaji maj është shoqëruar i gjithë ngjarjes. Në ç’ mënyrë autori na jep lidhjen midis muajit maj dhe Rinës? Jep një shembull për këtë. **2 pikë**



---



---



---



---



**PJESA II****Homeri****Kënga XXII. Iliada**

(Fragment)

“Medet. Ja zotat tani më thërresin  
 Ndër thonjtë e vdekjes...  
 Mortjen e zezë nuk e kemi larg, po qaset  
 Dhe s’kam shpëtim. Shumë kohë me shpirt më deshën  
 Zeusi dhe i biri Feb largshigjetuesi  
 Dhe dikur, besa, gjithnjë zot më dilnin  
 Tash ora e zezë të ma marrë shpirtin erdhi,  
 Por unë pa luftë a pa lavdi nuk vritem,  
 Dhe do të kryej një punë të denjë kreshnike,  
 Që brez pas brezi, ta kujtojë njerëzia”  
 Si foli ashtu, pallën si arëza e nxori,  
 Që e madhe, e rëndë në rrip të mezit varej.  
 Kular kukzuar iu vërtit Akilit,  
 Porsi shqiponja që prej t’eprash maja  
 Zbret në lëndinë thikë përmes resh të zeza,  
 Për të rrëmbyer ndonjë lepur t’frikshëm  
 A qengj të njomë. Ashtu u turr Hektori,  
 Duke lëkundur t’mprehtën pallë si arëza,  
 Po atij rrëmbyeshëm iu vërtit dhe Akili,  
 Që zemra i digjej nga tërbimi i egër.  
 Gjoksin përpara ia mbulonte shqyti  
 Mjeshtërisht punuar, dhe valë-valë i dukej  
 Kaska vetuese katër rrathësh tunxhi  
 Me katër kreshta ari vezulluese,  
 Që në majë pranë e pranë vendosi Efesti.  
 Si ylli i mbrëmjes që shkëlqen më i bukuri  
 Në mes të natës ndër yjet e qiellit,  
 Ashtu vetonte maja e heshtës tunxhi,  
 Që dora e fortë e Akilit vringëllonte,  
 Duke shartuar zi për Hektor divin,  
 Dhe hulumtonte trupin e tij t’hijshtëm  
 Ku mund t’ia hapte pagën vdekjeprurëse.  
 Armët e bukura tunxhi, që Priamidi  
 Ia kish rrëmbyer kurmit të Patroklit,  
 Kur përdhunisht këtij ia shkuli shpirtin,  
 Shtatin vigan ia mbronin përveç grykës,  
 Ku ndahet qafa me të gjërat shpatulla,  
 E ku më i hollë se askund është filli i jetës,  
 E n’zverk pas qafe i doli maja e heshtës  
 Arma mizore tejzat ia këputi  
 Përveç skërfyellit, ende i mbeti  
 Një fije zëri sa t’fliste Akilit,  
 Gjunjët iu shkrehën dhe u plandos në pluhur.

Për pyetjet 14-19 rretho **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

14. Vargjet e mësipërme karakterizohen nga nota:

1 pikë

- A) lirizmi.
- B) heroizmi.
- C) dramatizmi.
- D) ekzaltimi.

15. Pasioni njerëzor që dominon në këtë fragment është:

1 pikë

- A) dashuria.
- B) dhimbja.
- C) xhelozia.
- D) mëria.

16. Ndërhyrja e Zotave në dyluftimin midis Akilit dhe Hektorit, synon:

1 pikë

- A) të shtyjë ngjarjen drejt fundit.
- B) të mbrojnë njërin nga personazhet.
- C) të shërbejë si sfond për ngjarjen.
- D) të reflektojë fuqi hyjnore.

17. Procesi i dyluftimit është përballje midis:

1 pikë

- A) dy personave.
- B) dy ushtrive.
- C) dy grupeve.
- D) dy vendeve.

18. Funkzioni i inversionit në vargun: “Po atij rrëmbyeshëm iu vërtit dhe Akili” është:

1 pikë

- A) të shpjegojë arsyen se përse ndodh veprimi.
- B) të krahasojë dy veprime me njëri-tjetrin.
- C) të tregojë thjesht se çfarë po ndodh.
- D) të dallojë më mirë veprimin e personazhit.

19. Cili nga pohimet e mëposhtme i përshtatet më shumë fragmentit?

1 pikë

- A) Arsyeja përshkon ndeshjet e mëdha.
- B) Dinjiteti duhet të shoqërojë fundin e jetës.
- C) Dyluftimet pëlqehen nga njerëzit.
- D) Betejat zgjidhin konflikte të vogla.

20. Kush bëhet shkak i këtij dueli? Cila është origjina e Akilit? Po e Hektorit?

3 pikë

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

21. Shpjego kuptimin e shprehjeve të mëposhtme:

4 pikë

a) Zotat tani më thërrasin: \_\_\_\_\_

b) Ora e zezë: \_\_\_\_\_

c) Punë e denjë kreshnike: \_\_\_\_\_

d) Gjunjët iu shkrehën: \_\_\_\_\_

22. Autori sinjalizon se diçka do të ndodhë që në fillim të fragmentit. Cila është fjala e parë paralajmëruese? Çfarë paralajmëron ajo?

2 pikë

a) fjala: \_\_\_\_\_

b) paralajmërimi i saj: \_\_\_\_\_

23. Duke u mbështetur në fragment, shpjego ku qëndron forca e Akilit. Shoqëroje figurën e Akilit me dy mbiemra që i shkojnë për shtat natyrës së tij.

3 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

24. Gjej dy krahasime të zgjatura (similituda), me anë të të cilave rrëfohen momentet, kur heronjtë e fragmentit godasin njëri-tjetrin.

2 pikë

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

25. Cili është opinioni i autorit për Hektorin, duke u nisur nga fundi i tij? Si vdes Hektori? Përshkruaj dy tipare të tij, që dalin gjatë gjithë fragmentit.

4 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_